



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 195, datë 31.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË KRYETARIT DHE ANËTARËVE TË KËSHILLIT
TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA -
SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE
TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 14 dhe 15 të Ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, nenet 24 dhe 25 të Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “ Për fondet e pensionit vullnetar”, dhe Rregullores nr.112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Adrian Totokoçi në pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Administrimit dhe të z. Abdyl Sarja, z. Edvin Hoxhaj, z. Klement Mersini, në pozicionin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Sigal Life Uniqa Group Austria - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE